



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 05.7.2013, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavleviq, Vjosa Osmani, Ismet Beqiri, Alma Lama, Blerim Shala, Suzan Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Blerta Deliu – Kodra.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 28.06.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L -221 dhe nr. 04/L-116, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-148, për tregtinë e mallrave strategjike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 28 qershor 2013

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L -221 dhe nr. 04/L-116, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi, e ftoi deputetin Albert Kinolli, referues të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli, tha se legjislacioni i Bashkimit Evropian, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të cilat janë të adresuara në këtë projektligj, nuk i rregullon me legjislacion të përgjithshëm të BE-së. Shtetet anëtare të BE-së, këto çështje i rregullojnë sipas politikave të tyre të brendshme kombëtare.

Andaj, pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr .03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr .03/L -221 dhe nr. 04/L-116, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk rregullohet me Acqui të BE-së.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-148, për tregtinë e mallrave strategjike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesi, ftoi deputeten Suzan Novobërdali, referuese të projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzan Novoberdali, tha se Projektligji për tregtinë e mallrave strategjike rregullon kufizimin ose ndalimin e eksportit, importit, transitit, trans-ngarkimit dhe rieksporit të mallrave strategjike që hyjnë, dalin ose që kalojnë nëpër territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë rieksportin jashtëterritorial, ritransferimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura, që kanë të bëjnë me ndonjë nga mallrat që i nënshtrohen këtij ligji.

Projektligji për tregtinë e mallrave strategjike, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, është shqyrtuar dhe pasi që është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

***Kryesuesi** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-148, për tregtinë e mallrave strategjike, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis të BE- së.

5. Të ndryshme

a) Vizita e ish- zëvendëskryenegociatores së Kroacisë, znj. Tamara Obradoviç- Mazal

Kryesuesi, njoftoi anëtarët e Komisionit se ish-zëvendëskryenegociatorja e Kroacisë, znj. Tamara Obradoviç- Mazal, do të qëndrojë në Kosovë, nga data 23 korrik, deri më 25 korrik 2013. Gjatë kësaj periudhe, është paraparë një takim njëorësh me Komisionin për Integritet Evropian, për të ndarë eksperiencën e Kroacisë, në kuadër të procesit të integritetit evropian. Andaj, kërkoi që të caktohet data e përshtatshme për takim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryesuesi konstatoi se si datë e përshtatshme për takim, është data 24 korrik 2013.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

E përgatiti:

Kryetar i Komisionit

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Lutfi HAZIRI